

V E N D I M
Nr.14, datë 8.11.1995

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Rustem Gjata,	Kryetar	i Gjykatës Kushtetuese
Manol Konomi,	Anëtar	i “““
Veli Budo,	Anëtar	i “““
Zija Vuci,	Anëtar	i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar	i “““
Metush Saraçi,	Anëtar	i “““
Franc Jakova,	Anëtar	i “““
Hilmi Dakli,	Anëtar	i “““

me sekretare Drita Filto, më datat 9.6.1995, 16.6.1995, 30.6.1995, 7.7.1995, 19.7.1995 dhe 8.11.1995, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.9 Akti, që i përket:

K Ë R K U E S: Vlash Marini, i përfaqësuar nga Avokati Kujtim Puto.PERSON I INTERESUAR: Këshilli i Ministrave, në mungesë.

O B J E K T I:

Detyrimin e Këshillit të Ministrave t'i dorëzojë një kopje të vendimit datë 5.11.1993 të ish-Arbitrazhit të Shtetit pranë Këshillit të Ministrave.

GJYKATA KUSHTETUESE pasi dëgjoi relacionin përkatës,

V Ë R E N:

Nga shqyrtimi i çështjes u vërtetua se ish-kolegji i Arbitrazhit Shtetëror pranë Këshillit të Ministrave me vendimin nr.382, datë 5.11.1993, ka vendosur përfundimisht detyrimin e NEFINK Tiranë t'i paguaj kërkuarit Vlash Marini shumën prej 6 milion lekë.

Kërkuari, për të realizuar të drejtën e tij ka kërkuar nga Këshilli i Ministrave dorëzimin e kopjes së Vendimit të sipërm. Por Këshilli i Ministrave nuk ia ka dhënë Vendimin.

Mosdorëzimi i Vendimit të Arbitrazhit të Shtetit kërkuarit, jo vetëm që nuk është i përligjur, por për më tepër përbën edhe një shkelje e të drejtave të njeriut të sanksionuar nga neni 38 i ligjit nr.7692, datë 31.3.1993 “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”, i cili parashikon se : “Liria, prona ose të drejtat e pranuar me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor”.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 24 pika 9, 25 e 26 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, njëzëri

V E N D O S I:

Detyrimin e Këshillit të Ministrave t'i dorëzojë kërkuarit Vlash Marini, një kopje të vendimit nr.382, datë 5.11.1993 të Kolegjit të ish-Arbitrazhit Shtetëror pranë Këshillit të Ministrave.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi menjëherë.

ARSYETIM PARALEL

Gjatë shqyrtimit të çështjes doli se ndër shkaqet për mosrealizimin e detyrimeve kontraktore e si rrjedhojë për pagimin nga shteti të detyrimeve në vlerë mbi 250 mijë dollarë, kanë qenë edhe veprimet e paligjshme e burokratike të personave të caktuar zyrtarë. Prandaj është e nevojshme që

Këshilli i Ministrave të analizojë këtë çështje, të përcaktojë përgjegjësitë e personave si dhe masat me karakter ekonomik për zhdëmtimin e dëmit.

Tiranë, më 8.11.1995

A N Ë T A R I
Alfred Karamuço